



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
KOMITETI I EMËRIMIT DHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE

Nr. 1967/2 Prot.

Tiranë, më 11.10.2022

V E N D I M

Nr. 27/1 datë. 11.10.2022

**PËR VLERËSIMIN DHE PIKËZIMIN E KANDIDATURËS SË Z. ANDI MURATEJ NË VENDIN VAKANT PËR INSPEKTOR JO MAGJISTRAT, SHPALLUR NGA INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË NË DATËN 30.09.2021.**

Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve i përbërë nga:

Z. Besnik Maho - Kryetar  
Znj. Joana Asimi – Anëtar  
Z. Julian Zonja - Anëtar

Asistuar nga Sekretariati teknik i përbërë nga:

Znj. Alma Zili  
Znj. Eljona Bylykbashi  
Znj. Jetmira Saraçi

Në mbledhjen e datës 10.10.2022, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve mori në shqyrtim çështjen që i përket:

Kandidatit inspektor jomagjistrat

**Z. ANDI MURATEJ**

**OBJEKTI:**

**Vlerësimi dhe pikëzimi i kandidaturës së z. Andi Muratej në vendin vakant për Inspektor jomagjistrat, të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 30.09.2021.**

## KOMITETI PASI :

U njoh me aktet si edhe bisedoi çështjen në tërësi,

### VËREN:

#### I. Rrethanat e çështjes

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, pikës 3 dhe 77, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", me njoftimin e datës 30.09.2021, në faqen zyrtare ka shpallur procedurën për 9 vende vakante për pozicionin e inspektorit jomagjistrat. Shpallja ka qenë e hapur për 30 ditë, periudhë gjatë së cilës do të administrohet kërkesa e të interesuarve, bashkë me dokumentacionin e renditur në shpallje.
2. Në përfundim të afatit të shpalljes, me urdhrin nr. 142, datë 29.10.2021 "Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e Inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", të ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka ngritur Komitetin e Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, si organi që do të zhvillojë procedurat përzgjedhëse për plotësimin e vendeve të shpallura.
3. Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, në përfundim të afatit për paraqitjen e aplikimeve për shprehje interesi për kandidim datë 29.10.2021, zhvilloi mbledhjen e parë më datë 08.11.2021, ku vendosi për radhën e shqyrtimit të dosjes që i përket çdo kandidati dhe fillimin e procedurave/zhvillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve që kanë shprehur interes për vendin vakant për Inspektor jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë duke njoftuar në faqen zyrtare në rubrikën "Njoftime"; "Rekrutim Inspektorë Jo-Magjistratë" listën e personave të interesuar për vendin vakant dhe fillimin e shqyrtimit të aplikimeve të kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 209 dhe nenin 211, pika 2 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar dhe të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të

kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”.

4. Në zbatim të nenit 209 e vijues të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, të pikës 27, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Komiteti i Emërimeve dhe Vlerësimit të Inspektorëve, pasi zhvilloi procedurat e verifikimit të përmbushjes së kushteve dhe kriterëve ligjore për pozicionin e inspektorit, në mbledhjen e datës 07.07.2022, vendosi lejimin e kandidimit për pozicionin e inspektorit jomagjistrat për z. Andi Muratej dhe me komunikimin e datës 14.09.2022, njoftoi kandidatët për fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve.
5. Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve me vendimin nr.27, datë 07.07.2022 ka vendosur lejimin e kandidimit të kandidatit Andi Muratej për Inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Për rrjedhojë, në bazë të nenit 209 e vijues të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, duke u bazuar në aktet që janë dorëzuar nga kandidati në momentin e kandidimit dhe gjatë fazës përgatitore të procedurës së vlerësimit, hartoi relacionin e vlerësimit të këtij kandidati.
6. Sipas kalendarit të intervistave të miratuar, në 21.09.2022 dhe 22.09.2022, ka zhvilluar procedurën e intervistës me kandidatët e lejuar, mbi motivimin e kandidimit, për 9 (nëntë) vendet vakante.
7. Intervista mbi motivimin e kandidimit, z. Andi Muratej, kandidati për të 9 (nëntë) vendet vakante në Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, u zhvillua në datën 21.09.2022.

## **II. Vlerësimi i Komitetit**



8. Në përfundim të intervistës, bazuar në të dhënat e nxjerra nga biseda mbi motivimin e kandidimit, si edhe bazuar në aktet dhe dokumentet që janë dorëzuar nga kandidati në momentin e paraqitjes së kërkesës për kandidim, dokumente të paraqitura prej tij sipas kërkesave të Komitetit, si edhe shkresa dhe të dhëna të tjera kërkuara apo të ardhura zyrtarisht nga institucione të ndryshme, Komiteti ka vënë në bisedim vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatit Andi Muratej për secilin nga kriteret e vlerësimit të përcaktuara në shpjegimet e hollësishme të metodologjisë mbi të cilën bazohet vlerësimi dhe pikëzimi, miratuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë me urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, “Për miratimin e rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, përkatësisht:

### **1. Meritat profesionale - (50 pikë)**

#### **A. Historiku Arsimor dhe Profesional - (10) pikë**

9. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati Andi Muratej, disponon këto të dhëna:
- Specialist, në Zyrë e Ekzekutimeve të Vendimeve Gjyqësore, Drejtorinë e Organizimit Gjyqësor, për periudhën 22 Nëntor 2004 - 09 Shkurt 2007;
  - Përgjegjës Sektori të Inspektimit dhe Koordinimit me IEVP, në Drejtorinë e Profesioneve të Lira dhe Institucioneve të Varësisë, Ministria e Drejtësisë për periudhën 09 Shkurt 2007-20 Shkurt 2007;
  - Specialist në Sektorin e Inspektimit dhe Koordinimit me IEVP, në Drejtorinë e Profesioneve të Lira dhe Institucioneve të Varësisë, Ministria e Drejtësisë për periudhën 20 Shkurt 2007-07 Mars 2008;
  - Specialist në Sektorin e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë, në Drejtorinë e Inspektimit, Ministria e Drejtësisë për periudhën 07 Mars 2008-03 Prill 2009;
  - Inspektor në Drejtorinë e Inspektimit Administrativ, Ministria e Drejtësisë për periudhën 03 Prill 2009- 22 Shkurt 2010;
  - Inspektor Jurist në Inspektoratin Ndërtimor dhe Urbanistik Kombëtar, 31 Gusht 2010 - 16 Shkurt 2011;
  - Avokat shteti pranë Ministrisë së Arsimit, Avokatura e Shtetit, 17 Shkurt 2011-19 Maj 2014;
  - Koordinator projekti, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, 19 Maj 2014 - 20 Gusht 2016;
  - Jurist, avokat dhe koordinator projekti, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, 5 Shkurt 2017 - 14 Prill 2018;

- Ekspert ligjor, avokat dhe koordinator projekti, shoqata "Together for life", 14 Prill 2018-21 Shtator 2019;
- Këshilltar në Departamentin e Shërbimeve Ligjore, pranë Këshilli të Lartë të Prokurorisë 25 Shtator 2019 - deri në ditën e paraqitjes së kërkesës.

#### a) Historiku Arsimor - (2) pikë

- Referuar shtojcës nr.2, të urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", përcaktohet si kriter vlerësimi edhe ecuria gjatë kryerjes së **arsimit të lartë juridik** me një notë mesatare jo më pak se 8 ose të barasvlershëm me të, ndërkohë që edhe shkronja "c" e pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, kërkon të vlerësohen rezultatet gjatë studimeve në ciklet e arsimit të lartë.
- Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati Andi Muratej:
  - Ka përfunduar Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës në periudhën 2001, duke u diplomuar "*Jurist*". Sipas certifikatës së notave të lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, rezulton se ka përfunduar studimet universitare me notë mesatare 9.1.
- Prandaj, Komiteti vlerëson me pikë ecurinë gjatë kryerjes së arsimit të lartë me një notë mesatare jo më pak se 8 ose të barasvlershëm me të, secilin kandidat, sipas përshkallëzimit me 1 pikë të notës mesatare mbi 8 dhe me 2 pikë të notës mesatare mbi 9, sikurse orientohet në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve.
- Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit "historiku arsimor", nisur nga nota mesatare 9.1, e arritur gjatë studimeve dhe diplomimit në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, Komitetit çmoi ta vlerësojë kandidatin **Andi Muratej** me **2 (dy) pikë**.

#### b. Kualifikime Pasuniversitare - (5) pikë

##### b.1 Studimet pasuniversitare - (1/5) pikë

- Referuar shtojcës nr.2, të urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të

Drejtësisë”, përcaktohet si kriter vlerësimi edhe mbajtja e titujve akademikë, gradave shkencore, ecuria dhe kryerja kualifikimeve pasuniversitare, studimeve dhe specializimeve afatgjata (përfshirë Shkollën e Magjistraturës), si edhe kryerja e trajnimeve afatgjata dhe afatshkurtra në fushën e të drejtave kushtetuese, të drejtave të njeriut, si edhe në fusha të tjera të së drejtës.

15. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati Andi Muratej të këtë ndjekur këto studime pasuniversitare.

- Periudha: Qershor 2014  
Diploma/Titulli i kualifikimit të fituar: Kursi për “Menaxhim Projekt” (niveli pasuniversitar)<sup>1</sup>  
Emri dhe lloji i institucionit arsimor: Instituti për Arsimin e Lartë (ISAAT), Tiranë
- Periudha: 15 Shtator–12 Dhjetor 2008  
Diploma/Titulli i kualifikimit të fituar: Kursi i Lartë për Studime në Fushën e Sigurisë dhe të Mbrojtjes. Ky kurs është ekuivalentuar sipas Certifikatës në Sigurinë Civile Ndërkombëtare, lëshuar nga Universiteti i Kolorados në Kolorado Springs (SHBA)  
Emri dhe lloji i institucionit arsimor: Kolegji Rajonal Shqiptar të Mbrojtjes, Akademia e Mbrojtjes “Spiro Moisiu”.
- Periudha: 22 Shtator–15 Dhjetor 2006  
Diploma/Titulli i kualifikimit të fituar: Programi Lider për Studime të Avancuara të Sigurisë  
Emri dhe lloji i institucionit arsimor: Qendra Evropiane për Studime të Sigurisë “George C. Marshall”
- Periudha: 01 Shtator–21 Shtator 2005  
Diploma/Titulli i kualifikimit të fituar: Programi i Zhvillimit “Prezantim me Administratën Publike”  
Emri dhe lloji i institucionit arsimor: Instituti i Trajnimit të Administratës Publike (sot Shkolla Shqiptare e Administratës Publike)
- Periudha: Mars 2004–Nëntor 2004

<sup>1</sup> Pjesa më me madhe e kurseve pasuniversitare, trajnimeve, konferencave, seminareve, ëorkshopeve, etj., brenda dhe jashtë vendit, shoqërohen nga dokumentet dhe dëshmitë përkatëse ndërsa për një pjesë të vogël të tyre, nga organizatorët nuk janë lëshuar dokumente për pjesëmarrjen.



Diploma/Titulli i kualifikimit të fituar: Kursi Pas-universitar për “Planifikimin, Drejtimin dhe Vlerësimin e ndërhyrjes publike në kuadër të reformës në sistemin e Qeverisjes Lokale”<sup>2</sup>  
Emri dhe lloji i institucionit arsimor: Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, në bashkëpunim me CEFAL Bologna, Universiteti Roskild dhe Universiteti i Bolonjës

16. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit për sa më sipër, rezulton që kandidati Andi Muratej të këtë ndjekur programe të studimeve të formimit të vazhduar në kuptim të nenit 80 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ku nisur nga kohëzgjatja dhe lloji i këtyre kurseve të zhvilluara, mbartin të njëjtën rëndësi me atë të një studimi pasuniversitar të ciklit të tretë të studimeve, për sa i përket numrit të krediteve.
17. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit “**Kualifikime Pasuniversitare**”, që lidhet me studimet pasuniversitare, Komiteti çmon ta vlerësojë kandidatin Andi Muratej me **1 (një) pikë**.

## **b.2 Gradat shkencore - (3/5) pikë**

18. Referuar shtojcës nr.2, të urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, përcaktohet si kriter vlerësimi edhe mbajtja e titujve akademikë, gradave shkencore, ecuria dhe kryerja kualifikimeve pasuniversitare, studimeve dhe specializimeve afatgjata (përfshirë Shkollën e Magjistraturës), si edhe kryerja e trajnimeve afatgjata dhe afatshkurtra në fushën e të drejtave kushtetuese, të drejtave të njeriut, si edhe në fusha të tjera të së drejtës.
19. Prandaj, në zbatim të ligjit, Komiteti vlerëson me pikë llojin e titujve akademikë dhe gradave shkencore, llojin, kohëzgjatjen, fushën dhe vendin e kryerjes së kualifikimeve pasuniversitare, studimeve, specializimeve dhe trajnimeve të kandidatëve, duke pasur parasysh shpërndarjen e pikëve, si edhe orientimet që përmbahen në metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për inspektor jomagjistrat.
20. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, nuk rezulton

<sup>2</sup> Pjesa më me madhe e kurseve pasuniversitare, trajnimeve, konferencave, seminareve, workshopeve, etj., brenda dhe jashtë vendit, shoqërohen nga dokumentet dhe dëshmitë përkatëse ndërsa për një pjesë të vogël të tyre, nga organizatorët nuk janë lëshuar dokumente për pjesëmarrjen.

që kandidati Andi Muratej të këtë fituar brenda ose jashtë vendit grada shkencore në bazë të të nenit 60, 61 dhe 79 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, (Dr, Phd, Prof apo Pro/asoc, Magjistraturë, etj).

21. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit “**Kualifikime Pasuniversitare**”, që lidhet me gradat dhe kërkimin shkencor, Komiteti çmon ta vlerësojë kandidatin Andi Muratej me **0 (zero) pikë**.

### **b.3. Lista dhe lloji i trajnimeve - (1/5) pikë**

22. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati Andi Muratej ka ndjekur disa veprimtari trajnimi afatshkurtra të dokumentuara, konkretisht:

- **Periudha: 21-25 Maj 2018**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: Vizitë Studimore 4-ditore me tematikë “Aksesi në Drejtësi tek të Miturit”, në kuadër të Projektit “Përfshirja sociale për një sistem drejtësie funksional dhe të hapur në Shqipëri”, mbajtur në Romë, Itali

Emri dhe lloji i institucionit arsimor : Save the Children, dega Shqipëri (OJF ndërkombëtare), në bashkëpunim me Qendrën për Shërbime dhe Praktika Ligjore të Integruara dhe Save the Children Itali, mbështetur nga Bashkimi Evropian.

- **Periudha: 17-19 Prill 2018**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: Trajnimi 3-ditor me tematikë “Udhëzuesit ndërkombëtarë dhe praktikat më të mira në fushën e monitorimit të sistemit gjyqësor, aksesit në drejtësi dhe drejtësisë për të mitur”, në kuadër të Projektit “Përfshirja sociale për një sistem drejtësie funksional dhe të hapur në Shqipëri”

Emri dhe lloji i institucionit arsimor: Save the Children, dega Shqipëri (OJF ndërkombëtare), në bashkëpunim me Qendrën për Shërbime dhe Praktika Ligjore të Integruara, mbështetur nga Bashkimi Evropian

- **Periudha: 20-22 Shtator 2017**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: Trajnimi tre-ditor me tematikë “Hartimi i Strategjisë së Advokimit, Komunikimit dhe Monitorim & Vlerësimit

Emri dhe lloji i institucionit arsimor : Koalicioni “Drejtësi për të Gjithë” (rrjet vullnetar i OJF-ve që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut dhe të drejtësisë), mbështetur nga USAID Shqipëri.

- **Periudha: Janar–Mars 2017**



Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: Trajnimi për vëzhgimin e seancave gjyqësore në kuadër të Projektit “Të punojmë së bashku për seanca gjyqësore të hapura dhe transparente në gjykatat e të gjitha niveleve në Shqipëri”

Emri dhe lloji i institucionit arsimor: Komiteti Shqiptar i Helsinkit (OJF), mbështetur nga USAID Zyra në Shqipëri

- **Periudha: 21 Dhjetor 2016**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar : Kursi mbi Çështjet kundër Diskriminimit, organizuar në kuadër të Programit për Edukimin mbi të Drejtat e Njeriut të Profesionistëve Ligjorë  
Emri dhe lloji i institucionit arsimor : Këshilli i Evropës, mbështetur nga Bashkimi Evropian

- **Periudha: 27–31 Nëntor 2015**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: Vizitë Studimore me tematikë “OJF-të dhe Gjyqësori, monitorimi, ndërveprimi, bashkëpunimi, komunikimi”, mbajtur në Varshavë, Poloni  
Emri dhe lloji i institucionit arsimor: INPRIS (OJF)

- **Periudha:07–11 Prill 2015**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: Konferenca ndërkombëtare vjetore “Ditët e Mbrojtësve të të Drejtave të Njeriut”, mbajtur në Stokholm, Suedi.  
Emri dhe lloji i institucionit arsimor : Civil Rights Defenders (OJF ndërkombëtare)

- **Periudha: 06-07 Mars 2015**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: Forumi i Dytë Rajonal mbi Shtetin e së Drejtës në Evropën Juglindore, mbajtur në Beograd, Serbi  
Emri dhe lloji i institucionit arsimor : Civil Rights Defenders dhe The AIRE Centre (OJF ndërkombëtare)

- **Periudha: 19 Shkurt 2015**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: Takimi Rajonal me tematikë “Reforma në Sistemin e Paraburgimit”, mbajtur në Prishtinë, Kosovë.  
Emri dhe lloji i institucionit arsimor : Qendra Kosovare e Rehabilitimit të Viktimave të Torturës (OJF)

- **Periudha: 04-05 Prill 2013**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: Seminari me tematikë ”E drejta e BE-së dhe MSA-ja. Liritë themelore të tregut të brendshëm. Kuadri i ligjit evropian dhe ai i MSA-së. Rr. e BE nga Matrihti te Lisbona. Arritje dhe Pengesa. Institucionet evropiane dhe kompetencat vendimmarrëse të tyre”

Emri dhe lloji i institucionit arsimor : Shkolla e Magjistraturës në bashkëpunim me Fondacionin Hanns Seidel Stiftung Foundation

- **Periudha: 29 Qershor 2011**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar : Seminari me tematike: ”Roli i Avokatit të Shtetit dhe ndihma në kontratat ndërkombëtare”  
Emri dhe lloji i institucionit arsimor: Avokatura e Shtetit dhe EURALIUS

- **Periudha: 01-04 Nëntor 2010**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: Seminari me temë "Direktiva Evropiane për Produktet e Ndërtimit (CPD) dhe zbatimimi i saj në Shqipëri". Njohuritë e arrira janë mbi Direktivën Evropiane 89/106/EEC për produktet e ndërtimit dhe udhëzimet për zbatimimin e kësaj direktive në Shqipëri  
Emri dhe lloji i institucionit arsimor : Instituti i Ndërtimit, Tiranë

- **Periudha: 9-11 Dhjetor 2008**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: Seminari Trajnues i Trajnerëve me tematikë "Shërbimi i Provës në Shqipëri"

Emri dhe lloji i institucionit arsimor: OSBE, Prezenca në Shqipëri

- **Periudha: Qershor 2008**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: ëorkshop me tematikë "Zbatimi i vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ)", Roli i Ministrisë së Drejtësisë në zbatimimin e vendimeve të GJEDNJ, Ligjshmëria e procedurave, Aspekte të përfaqësimit në GJEDNJ, Publikimi i vendimeve, problematika

Emri dhe lloji i institucionit arsimor: Ministria e Integritimit (Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme), Ministria e Drejtësisë, Komisioni i Venecias dhe Këshilli i Evropës

- **Periudha: 25-26 Shkurt 2008**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: Konferencë ndërkombëtare me tematikë "Harmonizimi i luftës kundër ryshfetit dhe korrupsionit në Evropë", mbajtur në Koln, Gjermani

Emri dhe lloji i institucionit arsimor: "dbb akademie dhe Këshilli i Evropës"

- **Periudha: 11-12 Dhjetor 2007**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: Trajnimi me tematikë "Drejtësia, Liria dhe Siguria: Çështje dhe Perspektiva"

Emri dhe lloji i institucionit arsimor: Ministria e Integritimit (Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme)

- **Periudha: 26-27 Prill 2007**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: Kursi mbi "Drejtësinë për të Miturit" me tematikë "Dënimet alternative të burgimit ndaj të Miturve"

Emri dhe lloji i institucionit arsimor : Shkolla e Magjistraturës, në bashkëpunim me UNICEF

- **Periudha: Shkurt 2007**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: Trajnimi me tematikë "Masat e sigurimit ndaj të Miturve" si pjesë e Kursit mbi "Drejtësinë për të Miturit"

Emri dhe lloji i institucionit arsimor : Shkolla e Magjistraturës, në bashkëpunim me UNICEF

- **Periudha: Korrik 2005**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar Seminari mbi të Drejtën e Bashkëpunimit Gjyqësor në Çështje të së Drejtës Civile

Emri dhe lloji i institucionit arsimor: Ministria e Drejtësisë

- **Periudha: Maj 2005**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: Vizitë Studimore me tematikë “Zbatimi i dënimeve alternative në Turqi”, mbajtur në Ankara, Turqi

Emri dhe lloji i institucionit arsimor : Këshilli i Evropës

- **Periudha: 26 Shkurt - 13 Mars 2005**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar Vizitë studimore me tematikë “Sistemi penitenciar austriak”, mbajtur në Grac, etj., Austri

Emri dhe lloji i institucionit arsimor: Institucioni i Ekzekutimit të Dënimeve Penale Gerasdorf, etj., Ministria e Drejtësisë, Austri

- **Periudha: Nëntor 2004**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: Konferenca Ad-Hoc e Drejtuesve të Administratave Penitenciare dhe të Shërbimit të Provës, mbajtur në Romë, Itali

Emri dhe lloji i institucionit arsimor: Departamenti i Administratës Penitenciare

- **Periudha: Tetor 2004**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: Takimi me ekspertë të Këshillit të Evropës, me tematikë “Dënimet alternative ndaj burgimit”, mbajtur në Romë, Itali

Emri dhe lloji i institucionit arsimor: Këshilli i Evropës

- **Periudha: Korrik 2004**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: Trajnimi “Akademia e Advokimit”

Emri dhe lloji i institucionit arsimor: Instituti Ndërkombëtar Republikan Tiranë (IRI), me mbështetjen e USAID

- **Periudha: Qershor 2004**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: Trajnimi me tematikë “Trajnimi i Profesionistëve të Sistemit të Drejtësisë lidhur me çështje të dhunës në familje”

Emri dhe lloji i institucionit arsimor: Shkolla e Magjistraturës dhe Qendra Avokatore e Grave, me mbështetjen e UNICEF

- **Periudha: Prill - Maj 2004**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar : Trajnim me tematikë “Programi Rajonal të Avancuar për të Drejtat e Njeriut”, mbajtur në Lund, Suedi

Emri dhe lloji i institucionit arsimor: Instituti “Raul Ëallenberg” (OJF për të drejtat e njeriut dhe të drejtën humanitare), Universiteti i Lundit dhe SIDA

- **Periudha: Janar 2004**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: Trajnimi me tematikë “Teknikat e Intervistimit, Sondazhet”

Emri dhe lloji i institucionit arsimor: Instituti Ndërkombëtar Republikan Tiranë (IRI), me mbështetjen e USAID

- **Periudha: 11-13 Dhjetor 2003**



Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: Konferencë Rajonale me tematikë “ Liria e Lëvizjes, Heqja e vizave në Evropën Juglindore”, mbajtur në Osijek, Kroaci  
Emri dhe lloji i institucionit arsimor : Citizens’ Pact for SEE (rrjet rajonal i OJF-ve)

• **Periudha: 20-21 Janar 2003**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: Trajnimi me tematikë “Promovimi i të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri”, me dy Module kryesore trajnimi: I. Koncepti i të Drejtave të Fëmijëve; II. Të Drejtat Bazë të Fëmijëve

Emri dhe lloji i institucionit arsimor: Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (OJF)

• **Periudha: Prill 2001**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: ëorkshop me tematikë “Përgatitja dhe gatishmëria në situata emergjente”

Emri dhe lloji i institucionit arsimor: UNHCR, Shqipëri

• **Periudha: 2000-2001**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: Seminari me tematikë “Mbi Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë” dhe në trajnimet me tema si: Përgatitja e një Projekt-Propozimi, Shkrimi i Raporteve, Mardhëniet me Median, Aspekte të Kodit të Procedurës Penale etj

Emri dhe lloji i institucionit arsimor: Komiteti Shqiptar i Helsinkit (OJF)

• **Periudha: Shtator 2000**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: Seminari me tematikë “Ligji nr. 8609, dt. 08.05.2000, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë ”

Emri dhe lloji i institucionit arsimor: Komiteti Shqiptar i Helsinkit (OJF), mbështetur nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë

• **Periudha: Mars 2000**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar : Kursi për Njohjen e Ligjshmërisë së Mjedisit

Emri dhe lloji i institucionit arsimor: Qendra Rajonale e Mjedisit, Shqipëri (OJF) dhe Fondacioni OSFA

• **Periudha: 21-24 Tetor 1999**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: Trajnimi me tematikë “Forcimi institucional i OJQ-ve që veprojnë në fushën e Drejtësisë”

Emri dhe lloji i institucionit arsimor: Qendra e Drejtësisë e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA)

• **Periudha: Korrik 1999**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: Trajnimi me tematikë “Monitorimi i të Drejtave të Njeriut”, mbajtur në Varshavë, Poloni

Emri dhe lloji i institucionit arsimor: Fondacioni i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Ministria e Punëve të Jashtme të Hollandës dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit

23. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit “**Kualifikime Pasuniversitare**”, që lidhet me trajnimet, Komiteti çmon ta vlerësojë kandidatin Andi Muratej me **1 (një) pikë**.

#### **c. Njohja e gjuhëve të huaja - (3) pikë**

24. Nga aktet që ndodhen në dosjen e kandidimit rezulton se kandidati ka vetëdeklaruar në jetëshkrim se është njohës i mirë i gjuhës së huaj angleze dhe asaj turke.

- Nga aktet që ndodhen në dosjen e kandidimit rezulton se kandidati ka:
- Certifikatë për mbrojtjen e Gjuhës Angleze, niveli C1 lëshuar nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, Qendra e Formimit Profesional Nr. 1, Shkodër; Foreign Language Centre “Wisdom”, European Center for Security Studies Certifikata për mbrojtjen e Gjuhës Turke, niveli B1 lëshuar nga Ambasada e Republikës së Turqisë.

25. Për këto arsye, duke pasur parasysh dokumentacionin e administruar, Komiteti çmoi ta vlerësojë kandidatin Andi Muratej për këtë kriter ligjor vlerësimi, në total me **2 (dy) pikë**.

#### **B. Kualifikimi i Përgjithshëm Profesional - (30) pikë**

26. Referuar shtojcës nr.2, të urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, përcaktohet si kriter vlerësimi edhe kualifikimi **i përgjithshëm profesional**, përcaktohen si kritere vlerësimi, në bazë të treguesve shkencorë, performanca e dalluar dhe rezultatet e larta në ushtrimin e profesionit, që mbështetet ndërmjet të tjerave në botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike, në produktet profesionale sipas profileve të ushtrimit të profesionit, rezultatet e vlerësimit profesional dhe të etikës të kandidatëve në punët që kanë bërë në të shkuarën, nëse ka, ose rezultatet e dallueshme të arritura gjatë përvojave të tyre të punës e që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën përkatëse.

27. Prandaj, në zbatim të ligjit, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve vlerëson me pikë si sasinë ashtu edhe cilësinë e rezultateve profesionale, me një fokus të veçantë tek cilësia. Në këtë mënyrë, bazuar në të dhënat e mundshme të disponueshme për vlerësim, mbahen parasysh sasia e pikëve maksimale **prej 30 pikësh** sipas urdhrit nr. 7 referuar si më sipër, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si edhe orientimet për caktimin e mundshëm të **një maksimumi prej 25 pikësh për sa i përket vlerësimit cilësor dhe të një maksimum prej 5 pikësh për vlerësimin e sasisë së rezultateve profesionale sipas Metodologjisë për vlerësimin** dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për Inspektor jomagjistrat.



28. Në rastin e kandidatit Andi Muratej, Komiteti shqyrtoi dokumente profesionale dhe të dhënat që mund të disponoheshin nga veprimtaria e tij profesionale ndër vite, si edhe nga kontributet e tjera profesionale të këtij kandidati në veprimtari të ndryshme, përfshirë publikime apo punime e artikuj shkencorë.

**a. Vlerësimi sasior - (5) pikë**

29. Për sa i përket **vlerësimit sasior**, krahas të dhënave që rezultojnë nga jetëshkrimi, rezulton se në dosjen e kandidimit është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm që ka të bëjë me aktivitetin profesional, kërkimin shkencor dhe publikimet nga ana e kandidatit z. Andi Muratej:
- Shkresa nr. 119, datë 24.01.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me anë të së cilës përcillet mendimi dhe sugjerimet për projektligjin “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” drejtuar Kuvendit të Republikës të Shqipërisë (8 faqe) ;
  - Praktika që lidhen me përfaqësimin në çështjen gjyqësore me palë ndërgjyqëse: Padiës, B.M, i paditur, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me objekt: Ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr. 214, datë 15.10.2020 të KLP-së, mbi të cilën është deklaruar mbarimi i statusit të magjistratit për ankuesin B.M dhe publikimin e vendimit të ndryshuar në faqen zyrtare të KLP-së (46 faqe);
  - Praktika që lidhen me përfaqësimin në çështjen gjyqësore me palë ndërgjyqëse: Padiës, B.N, I paditur: Qendra Spitalore “Nënë Tereza”, Tiranë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Objekti: Detyrimin e palëve të paditura, për shpërblimin e dëmit jo-pasuror, në formën e dëmit biologjik, dëmit moral dhe dëmit ekzistencial, në masën 60.000 lekë të reja të shkaktuar paditësit si dhe pagimin shpenzimeve gjyqësore nga palët e paditura(101 faqe) ;
  - Praktika që lidhen me përfaqësimin në çështjen gjyqësore me palë ndërgjyqëse: Padiës, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, I paditur, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Person i Tretë: B.N, Objekti: Shfuqizimi i vendimit nr. 17, datë 05.02.2019 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (37 faqe);
  - Praktika që lidhen me përfaqësimin në çështjen gjyqësore me palë ndërgjyqëse: Padiës, B.N, përfaqësuar në përgatitjen e kërkesë-padisë dhe në gjykim nga kandidati z. Andi Muratej, I Paditur: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Qendra Spitalore Nënë Tereza, Objekti: Detyrimin e palëve të paditura të dëmshpërblejnë paditësin për shkaktimin e dëmit biologjik, moral dhe ekzistencial (87 faqe).
  - Titulli i publikimit/ Kërkimit shkencor: Raport lidhur me zbatimin e Ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” nga ana e institucioneve qendrore të shtetit (7 faqe). Autor/Bashkautor/Kontribues : Komiteti Shqiptar i Helsinkit. Koha e botimit : Shtator 2017.



- Titulli i publikimit/ Kërkimit shkencor: Raport Studimor për denoncimin, hetimin dhe gjykimin e veprave penale në fushën e korrupsionit Autor/Bashkautor/Kontribues: Komiteti Shqiptar i Helsinkit. Koha e botimit : Dhjetor 2016.
  - Titulli i publikimit/ Kërkimit shkencor: Studim lidhur me “Veprat penale të torturës, trajtimit çnjerëzor dhe degradues si dhe praktika e hetimit dhe gjykimin të tyre në rrethet gjyqësore Tiranë dhe Elbasan” ( 8 faqe)
30. Mbështetur në këto të dhëna të rezultateve në ushtrimin e detyrës, si dhe në tematikën e përmbajtjen e produkteve profesionale të lidhura me ushtrimin e detyrës apo edhe me ushtrimin e profesionit, Komiteti vlerëson se në aspektin sasior kandidati Andi Muratej ka tregues të lartë angazhimi profesional, i cili rezulton të jetë dukshëm përtej asaj që mund të gjykohet si një angazhim i zakonshëm apo “mesatar” në ushtrimin e profesionit. Për këto arsye, Komiteti çmoi ta vlerësojë kandidatin Andi Muratej për këtë kriter ligjor vlerësimi me **5 (pesë) Pikë.**

#### **b. Vlerësim cilësor. 25 (njëzet e pesë) Pikë**

31. Për sa i përket **vlerësimit cilësor**, Komiteti shqyrtoi të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidati, veçanërisht pesë prej dokumenteve të përzgjedhura prej tij, me synimin për të evidentuar, bazuar në tregues shkencorë, elementë që dëshmojnë arritjen e rezultateve profesionale, shkallën e këtyre arritjeve, përfshirë elementë që nga këto dokumente profesionale dhe në tërësi nga veprimtaria profesionale e kandidatit dëshmojnë spikatjen dhe dallueshmërinë e tij në kuptimin dhe qëllimin për të cilin ligji e përcakton si kusht për vlerësimin e kandidaturës për këtë Komitet dhe, më tej, për përzgjedhjen e Inspektorit jomagjistrat.
32. Në veprimet përgatitore të kryera gjatë procedurave të verifikimit të kandidaturës, kandidati **Andi Muratej**, për qëllimet e procedurës së vlerësimit në kuadër të pikëzimit për “Kualifikimin e Përgjithshëm Profesional” dhe “Kualifikimin Shtesë Profesional”, ka paraqitur **pesë dokumentet profesionale** si më poshtë:
- Shkresa nr. 119, datë 24.01.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me anë të së cilës përcillet mendimi dhe sugjerimet për projektligjin “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarave me burgim dhe të paraburgosurve” drejtuar Kuvendit të Republikës të Shqipërisë (8 faqe). Në këtë shkresë zyrtare që KLP i përcjell Kuvendit të Republikës të Shqipërisë, propozimet përkatëse në lidhje me projektligjin “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarave me burgim dhe të paraburgosurve”, rezulton se kandidati z. Andi Muratej është njëri nga tre specialistët të cilët kanë kontribuar në konceptimin e propozimeve të dërguar;

- Praktika që lidhen me përfaqësimin në çështjen gjyqësore me palë ndërgjyqëse: Padiës, B.M, i paditur, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me objekt: Ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.214, datë 15.10.2020 të KLP-së, mbi të cilën është deklaruar mbarimi i statusit të magjistratit për ankuesin B.M dhe publikimin e vendimit të ndryshuar në faqen zyrtare të KLP-së (46 faqe). Në këtë praktikë, kandidati z. Andi Muratej ka bashkangjitur të gjitha katet procedurale të depozituar nga ana e KLP në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, për çështjen administrative ku ka qenë në pozitat e palës të paditur, sikurse janë , autorizim përfaqësimi, prapësime, prapësime shtese, kundërshtimi të parashtesës të paditësit në seancë gjyqësore si dhe vendimin nr.107, datë 23.12.2020 në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, që ka vendosur rrëzimin e padisë. Për sa i përket këtyre akteve procedurale rezulton se kandidati z. Andi Muratej ka qenë njëri nga specialistët dhe përfaqësuesit që ka mbrojtur interesat ligjore të KLP-së në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë;
- Praktika që lidhen me përfaqësimin e shtetasit A.B, në çështjen gjyqësore me palë ndërgjyqëse Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, i paditur, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Person i Tretë: A.B., Objekti: Shfuqizimi i vendimit nr. 255, datë 19.12.2018 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi(101 faqe). Në këtë praktikë është e administruar prokura e përfaqësimit që z. K.B ka lëshuar ndaj kandidatit z. Andi Muratej si avokat dhe përfaqësues i vëllait të tij A.B për ta përfaqësuar dhe mbrojtur para të gjitha institucioneve të administratës shtetërore dhe gjyqësore për pretendime që kanë të bëjë me shkaktimin e dëmit për arsye diskriminimi. Gjithashtu, si pjesë e praktikës janë edhe autorizim i Qendrës “Together for Life” lëshuar nga drejtuesi i kësaj Qendre për z. Andi Muratej, që të përfaqësojë z. A.B para Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ankesa drejtuar këtij institucioni, njoftim për seancë dëgjimore nga Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, parashtrime me shkrim si dhe vendimi i këtij institucioni që ka pranuar ankimin e shoqatës “Together for Life”, për diskriminimi që i ishte shkaktuar shtetasit A.B. Pjesë e praktikës janë edhe kërkesë-padia e MSjMS kundër vendimit të dhënë nga Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimin, ku kandidati z. Andi Muratej ka qenë përfaqësues në gjykim i Personit të Tretë z. A.B, si dhe vendimin nr. 80-2019, datë 12.03.2019 të Gjykatës Administrative të shkallës të Parë Tiranë që ka rrëzuar kërkesë padinë duke e konsideruar të marrë në përputhje me ligjin vendimin e marrë nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
- Praktika që lidhen me përfaqësimin e shtetasit B.N në çështjen gjyqësore me palë ndërgjyqëse: Padiës, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, i paditur, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Person i Tretë: B.N, Objekti: Shfuqizimi i vendimit nr. 17, datë 05.02.2019 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (37 faqe). Në këtë praktikë është e administruar autorizim i Qendrës “Together for Life” lëshuar nga drejtuesi i kësaj



Qendre për z. Andi Muratej, që të përfaqësojë z. B.N në pozitat procedurale të Personit të Tretë (ndërhyrës kryesor), para Gjykatës Administrative të shkallës të Parë Tiranë, në çështjen administrative me Paditës MShMC, kundër vendimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që ka konstatuar cenimin të interesave ligjore të shtetasit B.N, në formën e diskriminimit, kërkesë për ndërhyrje kryesore, parashtrime të ndërhyrësit kryesor, konkluzione përfundimtare si dhe vendimi nr. 2117 (80-2019-2189), datë 18.06.2019 të Gjykatës Administrative të shkallës të Parë Tiranë, që ka rrëzuar kërkesë padinë e MShMC, duke e konsideruar të marrë në përputhje me ligjin vendimin e marrë nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi;

- Praktika që lidhet me përfaqësimin në çështjen gjyqësore me palë ndërgjyqëse: Paditës, B.N, përfaqësuar në gjykim nga kandidati z. Andi Muratej, I Paditur: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Qendra Spitalore Nënë Tereza, Objekti: Detyrimin e palëve të paditura të dëmshpërblejnë paditësin për shkaktimin e dëmit biologjik, moral dhe ekzistencial, në masën 600.000 lekë të reja të shkaktuar paditësit si dhe pagimin shpenzimeve gjyqësore nga palët e paditura (87 faqe). Në këtë praktikë është e administruar kërkesë-padia e përgatitur nga kandidati z. Andi Muratej, si përfaqësues i shtetasit z. B.N në pozitat procedurale të Paditësit, kundër palëve të paditura MShMC dhe QSU ‘Nënë Tereza’, para Gjykatës Administrative të shkallës të Parë Tiranë, parashtrime të paditësit, konkluzione përfundimtare si dhe vendimi nr. 2828 (2886), datë 31.07.2019 të Gjykatës Administrative të shkallës të Parë Tiranë, që ka pranuar pjesërisht kërkesë padinë e shtetasit B.N përfaqësuar nga kandidati.
33. Në lidhje me tërësinë e dokumenteve profesionale të paraqitura nga kandidati **Andi Muratej** dhe, në veçanti, lidhur me pesë dokumentet profesionale të sipërcituara, për realizimin e vlerësimit profesional dhe të pikëzimit përkatës për këtë kriter ligjor vlerësimi, Komiteti shqyrtoi dhe bisedoi në mënyrë të posaçme dhe të kujdesshme përmbajtjen e tyre, duke u mbështetur mbi indikatorë shkencorë, sikurse janë orientime që përmbahen në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për Inspektor.(shtojca nr.2).
34. Dokumentet trajtojnë tematika në fushën e së drejtës në të cilën ka operuar ndër vite kandidati, përfshi ato që kanë të bëjnë me mbrojtjen e ligjshmërisë së veprimtarisë administrative të organeve shtetërore, mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit material e procedural në përmbushjen e detyrimeve të organit shtetëror si edhe të subjekteve dhe individëve në raport me të drejtat dhe detyrimet **përkundrejt organit shtetëror kompetent**. Në tërësi në të gjitha dokumentet që ka depozituar kandidati z. Andi Muratej, në kuadrin e vlerësimit profesional, spikat aftësia profesionale e kandidatit për të përgatitur akte procedurale sikurse janë kërkesë-padia, parashtrime, konkluzione dhe opinione që lidhen me ndryshimet e akteve ligjore, në funksionet që ai ka pasur si avokat, pranë Qendrës “Together for Life”, organeve të ndryshme



të administratës publike, Gjykatën Administrative të shkallës të Parë/ Apelit, dhe këshilltar në KLP. Bazuar në të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidati z. Andi Muratej, për sa më sipër si dhe intervista e zhvilluara me të nga ana e Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, vlerësimi i këtyre të dhënave bëhet në pesë komponentë kryesorë që janë, origjinaliteti dhe/ose impakti i veprimtarisë profesionale të kandidatit, aftësitë analitike, aftësitë kërkimore, saktësia dhe precizoni, si dhe qartësia.

#### **b/1. Originalitet dhe/ose impakti - (6) pikë**

35. Njëri nga indikatorët vlerësues të dokumenteve profesional është vlerësues të dokumenteve profesionalë është **“Originaliteti dhe/ose impakti”**. Nisur nga profili profesional i kandidatit Andi Muratej, përmbajtja e dokumenteve të analizuar dhe dobisë së tyre nga profesionistë të fushës apo grupeve të interesit, Komiteti vëren se dokumentacioni i paraqitur ofron një panoramë të elementëve të një qasje profesionale origjinale në trajtimin e çështjeve ligjore ë ka përfaqësuar kandidati në institucione të ndryshme shtetërore dhe ente publike, Qendrës “Together for Life”, Gjykatës Administrative, KLP.

36. Për rrjedhojë pas shqyrtimit të dokumentacionit, në zërin **“Originaliteti dhe impakti”**, Komiteti e vlerëson kandidatin me **2 (dy) pikë**.

#### **b/2. Aftësitë analitike - (6) pikë**

Për sa i përket treguesit vlerësues të lidhur me **“Aftësitë analitike”**, Komiteti duke u përqëndruar në arsyetimin e akteve procedurale/administrative të dorëzuar si dhe intervistën e zhvilluar me z. Andi Muratej, arrin në konkluzionin se kandidati zotëron aftësi të mira profesionale për të arsyetuar dhe zbatuar konceptet ligjore në fushën e operimit.

37. Për rrjedhojë, pas shqyrtimit të analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me zërin **“Aftësitë analitike”**, Komiteti vlerëson kandidatin me **3 (tre) pikë**.

#### **b/3. Aftësitë kërkimore - (4) pikë**

38. Në lidhje me treguesin **“Aftësitë kërkimore”**, Komiteti shqyrtoi dokumentacionin profesional të paraqitur nga kandidati.

39. Pas shqyrtimit të dokumentacionit në lidhje me treguesin **“Aftësitë kërkimore”**, Komiteti e vlerëson kandidatin me **2 (dy) pikë**.

#### **b/4. Saktësia dhe precizioni - (5) pikë**

40. Referuar kriterit “**Saktësia dhe precizioni**”, në thelb verifikohet nëse në veprimtarinë e tyre profesionale, kandidatët kanë mbuluar me profesionalizëm tematikën e përzgjedhur duke shmangur përsëritjet në material. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga kandidati, për aq sa është e mundur nga lloji i dokumentacionit, Komiteti vëren nivel të kënaqshëm të përcaktimit të tematikës dhe problemeve juridike.
41. Pas shqyrtimit të dokumentacionit në lidhje me treguesin “**Saktësia dhe precizioni**”, Komiteti e vlerëson kandidatin me **3 (tre) pikë**.

#### **b/5. Qartësia - (4) pikë**

42. Referuar kriterit “**Qartësia**”, në thelb verifikohet nëse në veprimtarinë e tyre profesionale, kandidatët e kanë strukturuar tematikën dhe problemin duke qartësuar gjuhën dhe duke përdorur në mënyrë të kënaqshme terminologjinë profesionale. Në rastin konkret, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga kandidati, Komiteti vëren nivel të kuptueshëm të parashtrimeve dhe qëndrimeve që a mbajtur kandidati para institucioneve shtetërore dhe enteve publike.
43. Pas shqyrtimit të dokumentacionit në lidhje me treguesin “**Qartësia**”, Komiteti e vlerëson kandidatin me **3 (tre) pikë**.
44. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, që përbëjnë **vlerësimin cilësor** të kandidatit, Komiteti vendosi të vlerësojë në të gjithë komponentët e mësipërm kandidatin z. Andi Muratej me **13 (trembëdhjetë) pikë**.

#### **C. Merita profesionale-Kualifikim shtesë profesional - (10) pikë**

##### **a. Përvoja dhe cilësia profesionale e posaçme për rolin dhe funksionet e Inspektorit pranë ILD-së - (7) pikë**

45. Rezultatet profesionale në lidhje me këtë kriter vlerësimi, shqyrtohen nga Komiteti për të vlerësuar veçanërisht rëndësinë dhe dobinë e profilizimit dhe specializimit të arritur në përvojat e veçanta profesionale të kandidatit të cilat tregojnë vlera të spikatura profesionale në shërbim të drejtimit, organizimit dhe funksionimit të inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të



Drejtësisë, si edhe të ushtrimit të kompetencave të këtij institucioni, përfshirë këtu vlerësimin e njohurive të posaçme profesionale në lidhje me ushtrimin e kompetencave të kontrollit, inspektimeve, hetimeve disiplinore si edhe kompetencave të tjera që përcaktohen nga ligji.

46. Prandaj, në zbatim të ligjit, në varësi edhe të profileve dhe karrierave profesionale të secilit kandidat, nga totali prej 10 pikësh për këtë kategori vlerësimi, Komiteti, vlerëson deri në 7 pikë ekspertizën në fushat e së drejtës dhe posaçërisht në çështjet e drejtimit, organizimit dhe funksionimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si dhe ushtrimit të kompetencave me natyrë kontrolli, inspektimi, hetimi disiplinor si edhe kompetencave të tjera që përcaktohen nga ligji. Gjithashtu, Komiteti vlerëson deri në 3 pikë angazhimet profesionale shtesë të kandidatëve. Në arsyetimin dhe përfundimet e tij Komiteti mban parasysh rregullat e hollësishme të përcaktuara urdhrin nr. 7 (si më sipër) të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si edhe orientimet në përcaktimin e pikëve përkatëse të merituar sipas metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve .
47. Veprimtaria profesionale që kandidati z. Andi Muratej si avokat, pranë Qendrës “Together for Life”, organeve të ndryshme të administratës publike, Gjykatën Administrative të shkallës të Parë/ Apelit, dhe këshilltar në KLP, nëpërmjet përgatitjes të akte procedurale sikurse janë kërkesë-padia, parashtrime, gjatë proceseve gjyqësore është një veprimtari që ka lidhje me rolin dhe veprimtarinë e Inspektorit të lartë të Drejtësisë.
48. Lidhur me këtë kriter, Komiteti pasi shqyrtoi dokumentet profesionale të depozituara në dosjen e kandidimit dhe të analizuar më sipër lidhur me rëndësinë që ato mbartin, të dhënat e jetëshkrimit, si dhe intervistën e zhvilluar dhe motivimin për kandidim, Komiteti i emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve për kriterin e “Përvojës dhe cilësisë profesionale që a ka ushtruar në raport me rolin dhe funksionet e inspektorit pranë ILD-së”, e vlerëson kandidatin z. Andi Muratej me **4 (katër) pikë**.

#### **b. Angazhime profesionale shtesë - (3) pikë**

49. Nga aktet e dosjes dhe nga vetëdeklarimet e kandidatit Andi Muratej, rezulton se ka paraqitur angazhime shtesë profesionale, krahas atyre që janë përmendur në këtë vendim, sikurse janë disa botime juridike në revistat shkencore si dhe marrja e licencës për ushtrimin e profesionit të “Avokatit”, dhe konkretisht:

- Titulli i publikimit/ Kërkimit shkencor: Raport lidhur me zbatimin e Ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” nga ana e institucioneve qendrore të shtetit (7 faqe)  
Autor/Bashkautor/Kontribuues : Komiteti Shqiptar i Helsinkit  
Subjekti/Institucioni botues/publikues : Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Koha e botimit : Shtator 2017

Faqja në ëeb ku gjendet publikimi (nëse disponohet) : [chrome-extension://ohfgljdgelakfkefopgklcohadegdpjf/https://ahc.org.al/ë\\_content/uploads/2017/12/Final-Raporti-i-njoftimit-dhe-konsultimit-publik.pdf](chrome-extension://ohfgljdgelakfkefopgklcohadegdpjf/https://ahc.org.al/ë_content/uploads/2017/12/Final-Raporti-i-njoftimit-dhe-konsultimit-publik.pdf)

- Titulli i publikimit/ Kërkimit shkencor: Raport Studimor për denoncimin, hetimin dhe gjykimin e veprave penale në fushën e korrupsionit

Autor/Bashkautor/Kontribuues: Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Subjekti/Institucioni botues/publikues : Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Koha e botimit : Dhjetor 2016

Faqja në ëeb ku gjendet publikimi (nëse disponohet) : [chrome-extension://ohfgljdgelakfkefopgklcohadegdpjf/https://ahc.org.al/ë\\_content/uploads/2016/12/raport-studimor24.12.16.pdf](chrome-extension://ohfgljdgelakfkefopgklcohadegdpjf/https://ahc.org.al/ë_content/uploads/2016/12/raport-studimor24.12.16.pdf)

- Titulli i publikimit/ Kërkimit shkencor: Studim lidhur me “Veprat penale të torturës, trajtimit çnjerëzor dhe degradues si dhe praktika e hetimit dhe gjykimit të tyre në rrethet gjyqësore Tiranë dhe Elbasan” ( 8 faqe)

Autor/Bashkautor/Kontribuues : Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Subjekti/Institucioni botues/publikues : Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Koha e botimit : Dhjetor 2015

Faqja në ëeb ku gjendet publikimi (nëse disponohet) : [chrome-extension://ohfgljdgelakfkefopgklcohadegdpjf/https://ahc.org.al/ë\\_content/uploads/2016/12/Studimi\\_per\\_Torturen\\_-\\_Komiteti\\_Shqiptar\\_i\\_Helsinkit.pdf](chrome-extension://ohfgljdgelakfkefopgklcohadegdpjf/https://ahc.org.al/ë_content/uploads/2016/12/Studimi_per_Torturen_-_Komiteti_Shqiptar_i_Helsinkit.pdf)

- Tituj Profesional.

Periudha: Maj 2003

Lloji i titullit/ fusha profesionale: Lejë ushtrimi i profesioni të “Avokatit”, licencë nr. 1719

Emri dhe lloji i institucionit që ka dhënë titullin: Dhoma Kombëtare e Avokatisë

50. Në lidhje me kriterin “Angazhimeve profesionale shtesë”, Komiteti i emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve e vlerëson kandidatin z. Andi Muratej me **2 (dy) pikë.**

51. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe kriterëve në kategorinë merita profesionale dhe kualifikim shtesë profesional, kandidati vlerësohet të total nga Komiteti me **6 (gjashtë) pikë.**



## **2. MERITA MORALE, ORGANIZATIVE, DREJTUESE DHE MENAXHERIALE - (50) pikë**

### **2/1. Merita morale - (25) pikë**

52. Si kriter vlerësimi është përcaktuar që kandidatët të jenë vlerësuar për integritet të lartë moral dhe profesional. Konkretisht përcaktohen si kritere vlerësimi edhe "*Reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve*" dhe "cilësi morale të tilla si: Ndershmëria, përpikëria, drejtësia në marrjen e vendimeve dhe ushtrimin e detyrave", si edhe "angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile".
53. Prandaj, në zbatim të ligjit, lidhur me meritat morale, nga totali prej 25 pikesh për të tre komponentët vlerësues, Komiteti vlerëson deri në 15 pikë integritetin etik dhe moral, deri në 8 pikë reputacionin që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve dhe deri në 2 pikë angazhimin e provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile.
54. Në rastin e kandidatit, krahas jetëshkrimit, paraqitjes dhe sjelljes parashtrimeve në intervistë, motivimit për kandidim dhe historikut të komunikimit të kandidatit me Komitetin gjatë procesit të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturës. Komiteti shqyrtoi të dhënat nga dokumentet profesionale, aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatit si edhe çdo të dhënë a dokument tjetër të aksesueshëm publikisht nëpërmjet të cilave mund të nxirreshin elementë të dobishëm për qëllimet e verifikimit dhe vlerësimit të meritave morale të këtij kandidati.

#### **a. Integriteti etik e moral - (15) pikë**

55. Për sa i përket kriterit të parë vlerësues, integritetit etik e moral, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista, komunikimi i kandidatit me Komitetin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht, Komitetit i rezulton se kandidati në veprimtarinë, sjelljen dhe komunikimin e tij tregon përkushtim dhe angazhim të ndërgjegjshëm në përmbushjen e detyrave profesionale dhe në ushtrimin e profesionit, si edhe vëmendje, ndjeshmëri dhe respekt në komunikim e bisedë, duke parashtruar argumentet e tij me kompetencë, dinjitet, duke dëgjuar dhe përgjigjur me kujdesin e duhur, me durim e vetëpërbajtje përkundrejt qëndrimeve dhe pyetjet të cilat i drejtohen nga bashkëbiseduesit.
56. Nga të dhënat e mundshme në dispozicion, Komitetit nuk i rezulton që kandidati të ushtrojë apo të ketë ushtruar funksionet e tij profesionale duke favorizuar palë të caktuara apo duke kërkuar përfitime për veten apo për të tjerët. Nuk rezultojnë të dhëna që ky kandidat të mos

ketë respektuar detyrimin profesional të nderit dhe të dinjitetit, të ndërtimit të marrëdhënieve profesionale dhe mirësjelljes në raport me kolegët, profesionistët e fushës, palët e përfshira në çështje pune etj. Pra nuk ka të dhëna që me sjelljen dhe veprimtarinë e tij në jetën profesionale dhe personale të ketë cenuar apo të rrezikojë të cenojë imazhin dhe figurën publike të nëpunësit shtetëror dhe sistemit të drejtësisë.

57. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të "*integritetit etik e moral*", Komiteti e vlerëson kandidatin z. Andi Muratej me **15 (pesëmbëdhjetë) pikë**.

#### **b. Reputacioni në shoqëri dhe midis kolegëve - (8) pikë**

58. Për sa i përket kriterit të dytë vlerësues të reputacionit që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve", nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim. Intervista, komunikimi i kandidatit me Komitetin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht, Komitetit i rezulton se kandidati me veprimtarinë dhe sjelljen në shoqëri, tregon angazhim dhe përkushtim në përmbushjen e detyrave për zbatimin e drejtë të ligjit në ushtrimin e kompetencave që i ngarkon ligji.

59. Në lidhje me vlerësimin e punës dhe reputacionin që kandidati z. Andi Muratej gëzon, rezulton se pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kandidati ka dorëzuar Rekomandim të datës 28.10.2021, lëshuar nga z. Gent Ibrahim i si titullar i të KLP-së, ku evidenton cilësitë kryesore etiko-profesionale të kandidatit, Rekomandim i datës 18.09.2003 lëshuar nga z. Qemuran Muratej si drejtues i Dhomës të Avokatisë Shkodër, Letër Referencë e datës 24.11.2017 lëshuara nga znj. Erida Skëndaj si Drejtore Ekzekutiv e Komitetit Shqiptar të Helsinkit në Shqipëri, Letër Referencë datë 09.11.2017, lëshuar nga z. Pajtim Ribaj si drejtues i Shoqatës "George C.Marshall" Shqipëri, si dhe disa vërtetime të lëshuara në organet punëdhënëse ku ka shërbyer kandidati që venë në dukje cilësitë e tija etiko-profesionale

60. Prandaj, duke konstatuar se me sjelljen dhe veprimtarinë e tij përmbush të gjitha pritshmeritë e aspektit moral për marrjen e përgjegjësive ligjore dhe institucionale, si edhe pritshmërinë e publikut për gëzimin e cilësive profesionale e morale për ushtrimin e detyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në lidhje me kriterin vlerësues "të reputacionit që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve", Komiteti e vlerëson kandidatin me **7 (shtatë) pikë**.

#### **c. Angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile - (2) pikë**

61. Për sa i përket kriterit të vlerësimit që lidhet me angazhimin në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista, komunikimi i kandidatit me Komitetin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe



nga dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht, Komitetit i rezulton se, përgjithësisht, kandidati ka qenë i angazhuar në veprimtari të tjera të lidhura me ushtrimin e detyrës ose të profesionit për ndjekje të kauzave të shoqërisë civile, sikurse janë autorizimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që e ka autorizuar për të qenë vëzhgues gjatë proceseve zgjedhore të zhvilluar me kërkesë të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, monitorimit të seancave gjyqësore në kuadrin e Projektit “Drejtësi për të gjithë”, po me kërkesë të Komitetit Shqiptar të Helsinkit. Gjithashtu, për tu vlerësuar është përfaqësimi dhe mbrojtja e lirive dhe të drejtave të qytetarëve, në pozicionin e avokatit/përfaqësuesit, për periudhën që ka qenë pjesë e Qendrës “Together for Life”.

62. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të **“Angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile”**, Komiteti e vlerëson kandidatin me **1 (një) pikë.**

63. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe kriterëve në kategorinë e meritave morale, kandidati vlerësohet të total nga Komiteti me **23 (njëzetetre) pikë.**

## **2/2. Meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale - (25) pikë**

64. Ky komponent zërthehet në disa nën komponentë të tjerë, konkretisht:

- a) cilësinë e platformës dhe të vizionit që paraqesin;
- b) aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore;
- c) aftësitë e komunikimit;
- d) aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore;
- dh) aftësitë e përfaqësimit publik."

65. Në bazë dhe për zbatim të ligjit, lidhur me këto kriterë vlerësimi, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” ku përcaktohen rregullime me të hollësishme si edhe shpërndarja e pikëve të vlerësimit sipas peshës specifike të këtyre kriterëve.

66. Prandaj, në zbatim të ligjit, lidhur me meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale, nga totali prej 25 pikësh për të pesë komponentët vlerësues të sipërcituar, Komiteti vlerëson deri në 8 pikë cilësinë e platformës dhe vizionin që paraqesin kandidatet, deri në 10 pikë aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale

dhe shoqërore, deri në 5 pikë aftësisë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik, si edhe me 2 pikë për aftësitë e të punuarit në grup dhe ambiente multidisiplinore.

67. Në arsyetimin dhe përfundimet e tij, Komiteti mban parasysh rregullat e hollësishme të përcaktuara me urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë" dhe Shtojcën nr. 2 të tij si edhe orientimet në përcaktimin e pikëve përkatëse të merituar sipas metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidateve për inspektor.
68. Komiteti shqyrtoi përmbajtjen e dokumentit me shkrim, platformës dhe arsyt apo motivet e kandidimit dhe vizionit të kandidatit lidhur me qasjen dhe qëndrimet e tij mbi rëndësinë dhe aspektet thelbësore të ushtrimit të detyrës së Inspektorit, mbi sfidat kryesore me të cilat duhet të përballlet Inspektori i Lartë i Drejtësisë në ushtrimin e përgjegjësive dhe kompetencave që i ngarkon Kushtetuta dhe ligji, si edhe lidhur me mendimet e kandidatit për çështjet që duhet të trajtohen me përparësi e në perspektivë për mirë organizimin dhe mirëfunksionimin e këtij institucioni të ri dhe shumë të rëndësishëm kushtetues, për ushtrimin efektiv dhe me nivel të lartë profesional e besueshmërie të kompetencave të tij në funksion të ndërtimit të një sistemi drejtësie të bazuar në integritetin profesional e moral, nisur edhe nga pritshmëritë e jashtëzakonshme të publikut pas miratimit dhe vënies në zbatim të reformës në drejtësi. Gjithashtu, në vlerësimin e këtij kriteri, Komiteti mban parasysh edhe parashtrimet dhe shpjegimet e dhëna nga ky kandidat gjatë intervistës dhe në përgjigje të pyetjeve që iu drejtuan nga anëtarët e Komitetit.

**a. Cilësinë e platformës dhe të vizionit që paraqet kandidati - (8) pikë**

69. Nisur nga dokumenti me shkrim dhe shpjegimet e paraqitura gjatë intervistës, Komiteti vëren se kandidati paraqiti një nivel të mirë në lidhje me rolin dhe pritshmëritë për ushtrimin e funksionit të inspektorit jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për sa i përket sfidave me të cilat do të përballlet Institucioni, objektivat për çështjet e organizimit dhe funksionimit cilësor dhe efektiv të institucionit kushtetues të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë duke vënë theksin të pavarësia e tij, respektimi i procesit të rregullt ligjor, zhvillimi i marrëdhënieve me publikun.
70. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues "Cilësia e platformës dhe vizionit të paraqitur" nga kandidatet, Komiteti e vlerëson kandidatin me **4 (katër) pikë.**



**b. Aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi, bazuar në përvojat e mëparshme profesionale shoqërore - (10) pikë**

71. Lidhur me aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi, Komiteti mbështetet pikësisht në të dhënat që lidhen me përvoja konkrete nga karriera e kandidatëve në funksione dhe pozicione të cilat kërkojnë dhe tregojnë marrjen përsipër të përgjegjësi dhe ushtrimin e vendimmarrjes në përmbushjen e kompetencave dhe të detyrave të ngarkuara, veçanërisht për aspektet e drejtimit dhe të administrimit të punëve. Në këtë drejtim, Komiteti shqyrton dhe vlerëson posaçërisht aftësitë e provuara ose premtuese për të marrë nisma, për të kërkuar zgjidhje, për të marrë përgjegjësi si edhe për të marrë në vendimet e duhura e në kohën e duhur sipas përcaktimeve të ligjit dhe në përgjigje të ndjeshmërisë së publikut.
72. Në rastin e kandidatit, krahas jetëshkrimit, parashtrimeve dhe bisedës në interviste, përmbajtjes së platformës dhe motivimit për kandidim, Komiteti shqyrtoi të dhënat nga dokumentet profesionale, si edhe aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatit. Për të evidentuar të dhëna në lidhje me aftësitë e provuara apo premtuese të këtij kandidati për të marrë vendime dhe përgjegjësi edhe në ushtrimin e funksionit të inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
73. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues “aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore”, Komiteti e vlerëson kandidatin me **4 (katër) pikë**.

**c. Aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik - (5) pikë**

74. Aftësitë e komunikimit, në të gjitha format, veçanërisht me nëpunësit dhe punonjësit e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me organet e tjera të qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe përfaqësuesit e tyre, me gjyqtarët dhe prokurorët, sikurse edhe në komunikimin dhe përfaqësimin publik e me të tretët, të shprehurit në mënyrë të qartë, lehtësisht të kuptueshme, të matur, me respekt dhe në mënyrë jo diskriminuese, luajnë një rol të rëndësishëm në kryerjen e funksionit kushtetues të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
75. Nga shqyrtimi i jetëshkrimit, mënyra dhe stili i parashtrimeve me shkrim të platformës, sjellja, mënyra e komunikimit dhe argumentimit gjatë bisedës në intervistë, si edhe nga përmbajtja, strukturimi dhe stili i hartimit të dokumenteve profesionale të administruara në dosjen e kandidatit, Komiteti vëren se kandidati zotëron aftësi të mjaftueshme për të komunikuar me maturi, për të dëgjuar me respekt dhe për t’u përgjigjur me profesionalizëm, qartësi e thjeshtësi, me stil dhe gjuhë të pasur në lidhje me të gjitha çështjet dhe problematikat që vlerëson të trajtohen, ashtu edhe për çështje dhe problematika që ngrihen nga të tjerët.

76. Gjithashtu referuar prezantimit të bërë gjatë intervistës, rezulton se ky kandidat zotëron edhe aftësi të mira për përfaqësimin publik, prezanton thjeshtësi, aftësi për të shprehur bindjet e tij me vetëbesim. Kandidati transmeton besueshmëri gjatë komunikimit dhe aftësi për t'u përgjigjur me etikë.

77. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të "Aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik", Komiteti e vlerëson kandidatin me **4 (katër) pikë**.

**d. Aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore - (2) pikë**

78. Inspektori për vetë natyrën e këtij institucioni dhe funksioni, duhet të zotërojë aftësitë e duhura për një qasje metodike ndaj punës, si dhe aftësinë për të organizuar dhe për të qenë i përfshirë në punën në grup, me nëpunësit dhe punonjës të Zyrës dhe për aq sa kërkohet dhe nevojitet me funksionarë e përfaqësues të institucioneve të tjera dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Pjesë e kësaj aftësie është edhe nevoja për tu përshtatur shpejt me zhvillimet e reja, si edhe ndaj nevojës për t'u përfshirë në veprimtari në ambiente multikulturore dhe multidisiplinore gjatë karrierës gjyqësore.

79. Nga shqyrtimi i jetëshkrimit, sjellja, mënyra e komunikimit dhe argumentimit gjatë bisedës në intervistë, si edhe nga dokumentet profesionale të administruara në dosjen e kandidatit, Komiteti vëren se kandidati zotëron aftësitë e duhura për të punuar në grup, përfshirë atë për të punuar në ambiente multikulturore dhe multidisiplinore.

80. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues "Aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore", Komiteti vlerëson t'i caktojë kandidatin **2 (dy) pikë**.

81. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe kriterëve në kategorinë e meritave organizative, drejtuese dhe menaxheriale, kandidati vlerësohet të total nga Komiteti me **14 (katërbëdhjetë) pikë**.

### **III - Vlerësimi përfundimtar i kandidatit**

82. Në përfundim të arsytimit mbi mënyrën dhe shkallën e vlerësimit për të gjitha kriteret ligjore të parashikuara nga ligji dhe të pikëzimit përkatës të treguar me sipër në këtë vendim, në funksion të procedurave ligjore të përzgjedhjes së Inspektorit jomagjistrat dhe për efekt të renditjes së kandidatëve për këtë vend vakant, Komitetit të Emërimit dhe Vlerësimit të



Inspektorëve i rezulton se kandidati z. Andi Muratej vlerësohet në total me **67 (gjashtëdhjeteshtatë) pikë**.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve:

### **V E N D O S I:**

1. Vlerësimin e kandidatit Andi Muratej, me **67 (gjashtëdhjeteshtatë) pikë**, në lidhje me kandidimin e tij për vendin vakant inspektor jomagjistrat, të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 30.09.2021.
2. Ky vendim i njoftohet kandidatit Andi Muratej.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në pjesën e përcaktuar për “Rekrutim Inspektor Jo magjistrat”.

### **KOMITETI I EMËRIMIT DHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE**

**ANËTAR**

**Julian Zonja**

**KRYETAR**

**Besnik Maho**

**ANËTAR**

**Joana Asimi**

